



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 30

Prishtinë, më 16.2.2016, ora 11,30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popović, Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Srdjan Popović**, nënkryetar i dytë i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 9.2.2016,
3. Shqyrtimi i propozimeve nga Avokati i popullit për Ligjin për shpronësime,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa verejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.2.2016

Procesverbali 9.2.2016 u miratua pa verejtje.

3. Shqyrtimi i kompetences se komisionit rreth Ligjit per Shpronësime

Kryesuesi hapi këtë pikë duke njoftuar se kompetenca e komisionit nuk është kontestues rreth ndryshimeve që kërkohen nga Avokati i popullit për Ligjin e shpronësimeve por fillimisht duhet të diskutohet edhe involvimi i ministrisë së financave ngase tri nene të Ligjit për shpronësime involvon edhe këtë ministri në rast se bëhet fjalë kush do të hartoi këtë ligj.

Servet Spahiu konstatoi se MMPH dhe Drejtoria për shpronësime është me kompetencë të plotë sa i përket hartimit të Ligjit apo ndryshimeve për këtë ligj, mirëpo duke pasur parasysh volumin e punëve në MMPH sugjeroi që ky komision të marr barën për këto ndryshime.

Shkelzen Morina nga MF gjithashtu konstatoi se në MF është biseduar si mund të realizohen ndryshimet e kërkuara, ndaj shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm.

Shaip Muja sugjeroi procedurën më të shkurtë dhe efikase duke formuar një grup punues i cili do të amendamentoi ligjin në fjalë.

Adem Salihaj u pajtua me sugjerimin që ky komision të marr barën e ndryshimeve që kërkohen duke formuar një grup punues ku do të marin pjesë zyrtarët që janë këtu present sot si dhe ekspertë që do të ftohen sipas nevojës, propozoi z. Hoxha për kryesues, për shkak të afërsisë së fushës së ligjit me profesionin që ka ai.

Murat Hoxha potencoi faktin se është duke u përgatitur për të udhëhequr grupin punues të monitorimit të Ligjit për Kadastër, megjithatë premtoi angazhim të plotë dhe sipas mundësive në këtë grup punues.

Kryesuesi në bazë të diskutimeve që u dëgjuan duke u bazuar në Nenet 53 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit rreth hartimit të ligjeve nga Komisionet parlamentare e mori këtë :

V E N D I M

- 1. MIRATOHET nisma për hartimin e Ligjit për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Shpronësimin e pronës së paluajtshme.**
- 2. Themelohet Grupi punues për hartimin e Ligjit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi me anëtarët si vijon : Murat Hoxha –kryesues, Adem Salihaj-anëtarë dhe Emilija Redzepi –anëtare.**
- 3. Ngarkohet stafi mbështetës i komisionit ti ofrojë mbështetje profesionale dhe teknike grupit të punës.**

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

4.Të ndryshme

Kryesuesi pyeti komisionin rreth shkresës së kryesuesit të GP për Obiliq i cili duhet të përcjellët Qeverisë-Kryeministrit, ndërsa **Adem Salihaj** vërtetoi se komisioni u pajtua lidhur me këtë çështje por mirë do të ishte të dërgohet edhe një herë anëtarëve të komisionit në shikim ose nënkryetari ta nënshkruaj atë dhe të dërgohet në Qeveri. **Nënkryetari Srdjan Popović** kërkoi nga stafi të dërgoi në shikim shkresën anëtarëve të komisionit dhe deri në mbledhjen tjetër ti dërgohet Qeverisë.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Nënkryetari i Komisionit,
Srdan Popović